



Npi – 01/213 datë: 31.05.2023

Kuvendi i Komunës së Shtimes, pas shumë diskutimeve për pikën e 4 të rendit të ditës “Propozim-Vendim për ndryshimin e vendimit të Kuvendit Npi-01/76 Për plotësimin e KPF me anëtarë të ri”, në mbledhjen e -V- të rregullt të Kuvendit të Komunës e mbajtur më 31.05.2023, miratoi këtë:

KONKLUZION

PËR SHTYRJEN E SHQYRTIMIT TË PIKËS 4 TË RENDIT TË DITËS ME ARSYETIMIN PËR ME KËRKUAR INTERPRETIM LIGJOR NGA - MAPL-ja

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e -V- të rregullt për vitin 2023, e mbajtur më 31.05.2023, Unanimisht vendosi që pika e rendit të ditës me numër 4 “Propozim-Vendim për ndryshimin e vendimit të Kuvendit Npi-01/76 Për plotësimin e KPF me anëtarë të ri”, të shtyhen për shqyrtim, deri në mbledhjen e radhës të Kuvendit, me arsyetimin që Ministria për Administrimin e Pushtetit Lokal, duhet me na dhënë sqarimin e saktë me Rekomandim (jo me përgjigje në kërkes) nëse është ose jo në përputhje me Ligjin, Vendimi i Kuvendit të Komunës së Shtimes me numër, Npi – 01/76 i datës 15.03.2023, “VENDIM për plotësimin e anëtares të Komitetit për Politikë dhe Financa, znj.Heroina Selmani nga Shtimja me zgjedhjen e anëtarit të ri, z.Reshat Mujota nga Mollopolci”.

II

Sekretaria e Kuvendit – Shtime, Kërkesës për interpretim Ligjor, nga Zyra Ligjore e MAPL-së do ja bashkëngjesim:

1. Vendimin e Kuvendit Npi-01/76 të datës 15.03.2023 “VENDIM për zëvendësimin e anëtarit të KPF-së Heroina Selmani me Reshat Mujota”.
2. Dokumentin e MAPL-së “Përgjigje në Kërkesë” Nr.020-282/8 të datës 12.05.2023.

III

Konkluzioni u dërgohet: Arkivit, Drejtorive, Kryesuesit të Kuvendit, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal si dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesi i Kuvendit
Adnan Ademi